



NDIHMJA JURIDIKE | PRAVNA POMOC  
LEGAL AID

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI PËR NDIHMË JURIDIKE  
KOMISIJA PRAVNE POMOCI  
LEGAL AID COMMISSION

---

# Raporti vjetor i punës së Komisionit për Ndihmë Juridike për vitin 2008

## **Përmbajtja :**

|  |              |
|--|--------------|
| <b>Hyrje.....</b>  | <b>3-4</b>   |
| <b>Zanafilla e Ndhmës juridike.....</b>  | <b>5-6</b>   |
| <b>Fushëveprimi dhe aktivitetet e Komisionit për Ndhmë Juridike.....</b>           | <b>6-8</b>   |
| <b>Funksionimi i komiteteve të Komisionit për Ndhmë Juridike.....</b>              | <b>9</b>     |
| <b>Aktivitetet e Zyrës Koordinuese për Ndhmë Juridike.....</b>                     | <b>9-18</b>  |
| <b>Aktivitetet e byrove të qarkut për Ndhmë juridike.....</b>                      | <b>18-25</b> |
| <b>Bashkëpunimi i Komisionit për Ndhmë Juridike me Odën e Avokatëve (OAK).....</b> | <b>26</b>    |
| <b>Bashkëpunimi i Komisionit për Ndhmë Juridike me OJQ-të në partneritet.....</b>  | <b>26</b>    |
| <b>Burimet financiare dhe niveli i financimit të Ndhmës juridike.....</b>          | <b>26</b>    |
| <b>Problemet, mangësitë dhe pengesat në sistemin e Ndhmës juridike.....</b>        | <b>27-28</b> |
| <b>Rekomandimet.....</b>   | <b>28</b>    |

I nderuari Kryetar i Parlamentit të Kosovës,  
E nderuara Kryesi,  
Deputetë të nderuar,

Jam i nderuar që më është dhënë rasti t' Ju përshëndes dhe t' ua përcjell konsideratat më të larta të stafit të Komisionit për Ndhimë Juridike dhe që para Jush të paraqes Raportin e dytë vjetor për punën e Komisionit për Ndhimë Juridike për vitin 2008.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së mirëkuptimit (MM) në mes të Komisionit për Ndhimë Juridike dhe Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut, më 24 qershor 2008, është bërë bartja e kompetencave nga ky Departament në Komisionin për Ndhimë Juridike.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka përcaktuar statusin dhe veprimtarinë e Komisionit për Ndhimë Juridike, gjë që dëshmon për rëndësinë e këtij institucioni në sistemin juridik të Kosovës.

Komisioni për Ndhimë Juridike është themeluar më 26 shtator 2007, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.2006/36, si organ i pavarur, përgjegjës për të siguruar ndihmë juridike falas, në çështjet penale, civile dhe administrative, për qytetarët e Republikës së Kosovës, për qytetarët e huaj që përkohësisht ndodhen në Kosovë (parimi i reciprocitetit) dhe për personat tjerë, të përcaktuar me ligj ose marrëveshje ndërkombëtare, të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me ligj për t' u ofruar ndihmë juridike falas.

Themelimi i këtij organi, i pari i këtij lloji në regjion, dëshmon për aspiratat e shoqërisë kosovare për një të ardhme më të mirë, ku sundimi i ligjit dhe respektimi i të drejtave të njeriut radhitën ndër objektivat e një rëndësie të veçantë.

Ky synim i shtetit të Kosovës dëshmohej edhe me përcaktimin e Ndhimës juridike si kategori kushtetuese. Në nenin 31 paragrafi 6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, thuhet: "Ndhimja juridike falas do t' u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasje efektive në drejtësi". Ndërsa me nenin 142 sigurohet baza ligjore e vazhdueshme e Ndhimës juridike, si agjenci e pavarur.

Në formimin dhe veprimtarinë e Komisionit për Ndhimë Juridike, roli i UNMIK-ut, veçmas në fillim, ishte parimor, gjë që nuk mund të mohohet por, më pas, ky rol u zbeh, dhe u bë pengesë në zhvillimin dhe funksionimin e mëtutejshëm të KNJ-së.

Kjo më së miri ilustron me faktin se në dy vitet e fundit kemi pasur zvogëlim të mjeteve buxhetore për këtë institucion.

Me insistimin e vazhdueshëm të KNJ-së, në qershor të vitit 2008, është nënshkruar Marrëveshja e mirëkuptimit me Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut, me ç’ rast bëhet bartja definitive e të gjitha kompetencave.

KNJ është ndër institucionet e para të sistemit të drejtësisë që i janë transferuar kompetencat e rezervuara .

Theksojmë se kapacitetet ekzistuese, qofshin ato njerëzore, organizative, ligjore e posaçërisht ato buxhetore, kur merret parasysh niveli i varfërisë së shfrytëzuesve potencialë të KNJ-së, nuk janë në nivelin e dëshiruar dhe kanë nevojë për rishqyrtime dhe për reforma rrënjësore.

Ne jemi zotuar dhe jemi të gatshëm t’ i bëjmë këto ndryshime, por na nevojitet mbështetja institucionale, e posaçërisht e Juaja të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në përmbushjen e mandatit të vet ligjor, KNJ do të bashkëpunojë ngushtë më të gjithë partnerët e vet vendës dhe ndërkombëtarë e, posaçërisht, me të autorizuarit që merren me implementimin e standardit për sundim të ligjit në Republikën e Kosovës, me synim që KNJ të shndërrohet në një institucion të pavarur bashkëkohor dhe efektiv, më qellim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe sasisë së shërbimeve, në mënyrë që t’i përgjigjet kompleksitetit dhe rëndësisë që i është besuar me ligj.

Në fund, më lejoni t’ Ju siguroj për përkushtimin e gjithë stafit të NJ-së, në përmbushjen e objektivave dhe obligimeve , gjithnjë në interesin e atyre qytetarëve të cilëve më se tepërmi u nevojitet ndihma juridike, e të tillë, fatkeqësisht, ka mjaft në vendin tonë.

Me respekt,  
Sokol Haziri  
Komisioner i ndihmës juridike

## **2. ZANAFILLA E NDIHMËS JURIDIKE**

Prej vitit 2001-2005, Agjencia Europiane për Rindërtim financoi Projektin “Ndhim juridike falas në çështje civile dhe administrative”, të implementuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës, e të realizuar nga OJQ-të vendëse. Pas përfundimit të Projektit, nga raportet e paraqitura është konstatuar se më shumë se gjysma e popullatës së Kosovës ka nevojë për ndihmë juridike falas.

Për këtë arsye, Agjencia Europiane për Rindërtim financoi edhe Projektin “Krijimi i sistemit gjithëpërfshirës të ndihmës juridike në Kosovë”, të realizuar nga agjencia gjermane Instituti ICON. Realizimi i Projektit luajti rol të rëndësishëm në institucionalizimin e Ndhimës juridike në vendin tonë.

Komisioni për Ndhimë Juridike, është organi i parë dhe i vetëm, i llojit të këtillë, në regjionin e Europës Juglindore, që ka për mision, si organ i pavarur, t’u sigurojë e ofrojë ndihmë juridike qytetarëve të Republikës së Kosovës të cilët, deri më tani, e kanë pasur të pamundur qasjen e barabartë në drejtësi, për shkak të mungesës së mjeteve materiale.

Komisioni vepron në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut për Ndhimë juridike, nr. 2006/36, e cila ka hyrë në fuqi më 7 qershor të vitit 2006. Në bazë të kësaj Rregulloreje, Ndhimja juridike në Kosovë ofrohet në tri nivele, nga :

- I. Komisioni për Ndhimë Juridike (Bord)
- II. Zyra Koordinuese për Ndhimë Juridike (Zyra Ekzekutive)
- III. Byrotë e qarkut për Ndhimë juridike (Zyrat operative)

Zyra Koordinuese ka filluar të funksionojë që nga muaji maj i vitit 2006. Në shtator të vitit 2007 është inauguruar Komisioni për Ndhimë Juridike dhe është punësuar pjesa dërmuese e stafit të Ndhimës Juridike, me ç’rast kanë filluar të funksionojnë byrotë e qarkut në 5 regjione të Republikës së Kosovës.

Ndhimja juridike falas u ofrohet qytetarëve të Republikës së Kosovës të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me Rregulloren për ndihmë juridike, nr. 2006/36.

## **Kriteret për Ndhmë juridike falas**

### **Ndhmë juridike u ofrohet:**

- banorëve me vendbanim të përhershëm të RK-së;
- banorëve me vendbanim të përkohshëm të RK-së nga shtetet të cilat, sipas parimit të reciprocitetit, u ofrojnë ndihmën juridike banorëve të përhershëm të RK-së;
- personave të tjerë të përcaktuar me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare.

- **Kriteri financiar**

#### **a) ndihma juridike primare u ofrohet:**

- personave që marrin ndihmë sociale ose janë në situatë të ngjashme financiare

#### **b) ndihma juridike sekondare**

- personave që kanë të ardhura të përgjithshme familjare më të ulëta se mesatarja e të ardhurave familjare, të përcaktuara nga Enti Statistikor i Kosovës.

- **Kriteri juridik**

Përfshin ndihmën juridike primare dhe sekondare kur çështjet kanë:

- a) vlerën relative
- b) arsyeshmërinë e argumenteve
- c) probabilitetin e suksesit të kërkesës
- d) ndërlikueshmërinë e rastit
- e) aftësinë e palës për vetëpërfaqësim

## ***3. FUSHËVEPRIMI DHE AKTIVITETET E KOMISIONIT PËR NDIHMË JURIDIKE (KNJ)***

### ***Mandati***

Komisioni për Ndhmë juridike është organ vendimmarrës që drejton dhe mbikëqyrë sistemin e Ndhmës juridike dhe është përgjegjës për të siguruar se ofrimi i Ndhmës juridike është i efektshëm, efikas, gjithëpërfshirës, fleksibil dhe i qëndrueshëm.

Komisioni për Ndhimë Juridike e ka për detyrë të sigurojë qasje të plotë në drejtësi për të gjithë pjesëtarët e komuniteteve që jetojnë në Kosovë dhe të sigurojë që Republika e Kosovës të përmbushë standardet për qasje në drejtësi, siç është garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Krahas mbikëqyrjes së ofrimit të ndihmës juridike në Kosovë, Komisioni për Ndhimë Juridike është gjithashtu përgjegjës për të siguruar që grupet e rrezikuara të shoqërisë, përfshirë komunitetet etnike jo shumicë, të kenë qasje në drejtësi, informim publik ligjor dhe të kërkojë nga Qeveria që procedurat për ndihmë juridike të jenë sa më të thjeshta, si dhe për të siguruar të dhëna statistikore për qasje në drejtësi.

Komisioni për Ndhimë Juridike edhe tani punon e vepron në bazë të Rregullores së UNMIK-ut për Ndhimë juridike, nr. 2006/36, dhe në bazë të legjislacionit sekondar në vijim, të miratuar nga Komisioni, që është në fuqi nga data 12 dhjetor të vitit 2007, si :

- 1. Doracakut për ndihmë juridike**, si mjet që u shërben zyrtarëve të byrove të qarkut për ndihmë juridike (BQNJ), në aplikimin e kësaj ndihme, të rregullave dhe praktikës juridike dhe në punën e tyre të përditshme.
- 2. Kodi i etikës për KNJ dhe personelin e NJ-së**, i cili përcakton standardet më të larta të mirësjelljes së stafit, duke përfshirë integritetin, paanshmërinë dhe objektivitetin.
- 3. Formularët** (aplikacionet) për kërkuesit e ndihmës juridike, për avokatë, ekspertë, etj.

### ***Përbërja e Komisionit***

Komisioni për Ndhimë Juridike përbëhet nga Komisioneri dhe tetë zëvendës, të cilët janë profesionistë për Ndhimë juridike dhe sistemin e drejtësisë në tërësi .

Komisioneri emërohet nga Kryeministri, pas konsultimit me Ministrin e Drejtësisë, me Komisionin e Kuvendit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, me kryetarin e Gjykatës Supreme, me Odën e Avokatëve të Kosovës dhe me organizata joqeveritare kombëtare e ndërkombëtare që zhvillojnë aktivitete nga fushat me rëndësi për funksionimin e sistemit të Ndhimës juridike.

Zëvendëskomisionerët emërohen nga Kryeministri, pas nominimit nga institucionet e përcaktuara me nenin 4 paragrafi 4 të Rregullores së UNMIK-ut për Ndhimë juridike, nr. 2006/36.

Në vijim japim listën e përbërjes së Komisionit:

| <b>Emri dhe mbiemri</b> | <b>Pozita</b> | <b>Mandati</b> |
|-------------------------|---------------|----------------|
| 1. Sokol Haziri         | komisioner    | 4 vjet         |
| 2. Altay Suroy          | zëvendës      | 3 vjet         |
| 3. Besa Krajku          | zëvendëse     | 3 vjet         |
| 4. Abdurrahim Broqi     | zëvendës      | 3 vjet         |
| 5. Sladjana Vasić       | zëvendëse     | 5 vjet         |
| 6. Fadil Racaj          | zëvendës      | 3 vjet         |
| 7. Isa Mustafa          | zëvendës      | 3 vjet         |
| 8. Gjylieta Mushkolaj   | zëvendëse     | 3 vjet         |
| 9. Virgjina Dumnica     | zëvendëse     | 3 vjet         |

### ***Aktivitet e Komisionit***

Angazhimin më të rëndësishëm Komisioni e ka realizuar pas kalimit të kompetencave nga UNMIK-u në Komisionin për Ndihmë Juridike, më 24.6.2008. Mirëpo, krahas kompetencave, nga UNMIK-u ka trashëguar edhe një varg problemesh financiare, që për pasojë kanë pasur zvogëlimin e ndjeshëm të buxhetit të Ndihmës juridike në Kosovë.

Vlen të theksohet se Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut ka qenë përgjegjës për zhvillimin e sistemit gjithëpërfshirës të Ndihmës juridike në Kosovë, por ai ka dështuar në harmonizimin e legjislacionit penal, përkatësisht të Kodit të përkohshëm të procedurës penale me Rregulloren për Ndihmë juridike. Për këtë arsye, sistemi i Ndihmës juridike ende nuk është gjithëpërfshirës, përkundër angazhimit maksimal të Komisionit dhe, për pasojë, buxheti i Ndihmës juridike, deri në fund të vitit 2008, ka mbetur i copëtuar dhe vazhdimisht është zvogëluar.

E arritura më e rëndësishme e Komisionit gjatë vitit 2008, është nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit midis Komisionit për Ndihmë Juridike dhe Odës së Avokatëve të Kosovës, më datën 3 dhjetor 2008, me të cilin janë vënë themelet për zhvillimin e procedurave unike referuese për t'u mundësuar të gjithë atyre që kërkojnë ndihmë juridike dhe që i përmbushin kërkesat ligjore, të kenë qasje në shërbimet e anëtarëve të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Komisioni për Ndihmë Juridike e ka për obligim ligjor të mbajë, së paku, nga një mbledhje në muaj por, për shkak të çështjeve të shumta të paraqitura, në vitin 2008 i ka mbajtur tetëmbëdhjetë mbledhje.



#### **4. FUNKSIONIMI I KOMITETEVE TË KOMISIONIT PËR NDIHMË JURIDIKE**

Në përputhje me nenin 4.15. pika (t) tw Rregullores së UNMIK-ut për Ndhmë juridike, nr 2006/36, Komisioni për Ndhmë Juridike , në kuadër të përgjegjësiive të tij, themelon komitete nga radhët e anëtarëve të Komisionit, të cilëve u delegohen përgjegjësi të veçanta të Komisionit, duke përfshirë buxhetin dhe financat, cilësinë e kontrollit, ankesat, burimet njerëzore, mbledhjen e kontributeve nga donatorët dhe edukimin juridik publik.

Gjatë vitit 2008 në kuadër te KNJ-së janë formuar këto 6 komitete:

1. Komiteti për buxhet dhe financa;
2. Komiteti për mbledhjen e kontributeve nga donatorët;
3. Komiteti për burime njerëzore;
4. Komiteti për ankesa;
5. Komiteti për kontrollin e cilësisë, dhe
6. Komiteti për edukim juridik publik.

Veprimtaria e komiteteve ka qenë në nivel të përgjegjësiive dhe detyrave të paraapara.

Janë shqyrtuar ankesat e paraqitura dhe një varg çështjesh që kanë të bëjnë me buxhetin dhe financat e KNJ-së dhe janë marrë veprime përkatëse për burimet njerëzore.

#### **5. AKTIVITETET E ZYRËS KOORDINUESE PËR NDIHMË JURIDIKE**

Zyra Koordinuese për Ndhmë Juridike (ZKNJ) është zyre qendrore në sistemin e Ndhmës juridike e, njëkohësisht, edhe Sekretariat i Komisionit. Është përgjegjëse për funksionimin e duhur të Ndhmës juridike, për caktimin dhe mbikëqyrjen e punës së të gjithë të punësuarve në Ndhmë juridike dhe të kryerjes së punëve sipas kontratave.

Është përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike dhe për zbatimin e politikës së Ndhmës Juridike në të gjitha aspektet.

Zyra Koordinuese për Ndhmë Juridike i ka kryer të gjitha punët operative ditore lidhur me shërbimet e ofruara të Ndhmës juridike, punët që kanë të bëjnë me administrimin e sistemit të Ndhmës juridike dhe me mbikëqyrjen e byrove të qarkut për Ndhmë juridike.

Zyra Koordinuese ka menaxhuar dhe mbikëqyrë punën e të punësuarve në KNJ.

Me qëllim të intensifikimit të komunikimit dhe referimit efikas të rasteve, Zyra ka mbajtur takime të rregullta mujore me përfaqësuesit BQNJ-së.

ZK i ka dhënë përkrahje administrative Komisionit për Ndhmë Juridike dhe i ka zbatuar me përpikëri vendimet e KNJ.


Në vitin 2008 ZK ka monitoruar punën e zyrtarëve në BQNJ-të, duke i identifikuar rastet më të veçanta, më specifike me ç ‘rast është njoftuar me problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen zyrtarët e zyreve regjionale.

Raporti vjetor i punës së ZK-së për vitin 2008 do t’i paraqitet dhe dorëzohet Komisionit dhe, pas miratimit nga Komisioni, do t’i i dorëzohet Kuvendit të Republikës së Kosovës

Zyra Koordinuese e Ndhmës Juridike e organizon punën e saj në bazë të RRNJ-2006/36. Këto rregulla përcaktojnë qartë përgjegjësitë e çdo zyrtari, si në ZK ashtu edhe në byrotë e qarkut për Ndhmë juridike.

Duke u nisur nga fakti se sistematizimi ekzistues, që pasqyron strukturën organizative të Ndhmës juridike, është përcaktuar nga UNMIK-u dhe, si i tillë, i imponuar, kjo strukturë organizative nuk i mundëson KNJ-së që të realizojë misionin e ofrimit të ndihmës juridike në mënyrë të suksesshme dhe në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/36 për Ndhmë Juridike.

Në vijim po japim sistematizimin e përcaktuar nga UNMIK-u



ZK është e përbërë nga Koordinator, 2 Zyrtarë Ligjor, 1 Zyrtarë i Lartë për Financa, 1 Zyrtar i Prokurimit dhe 1 Zyrtar për Teknologji Informative.

Me këtë strukturë të stafit ZK nuk mund t'i përmbushë të gjitha aktivitetet që e karakterizojnë një institucion të mirëfilltë çfarë është KNJ.

Gjatë vitit 2008 Zyra Koordinuese është përballur me një varg problemesh që kanë penguar funksionimin më efikas të saj. Ndër problemet kryesore ka qenë mungesa e mjeteve të domosdoshme buxhetore, gjë që ka ndikuar të mos punësohet numër i nevojshëm i zyrtarëve. Edhe kalimi në një tjetër objekt me qira, ka shkakuar vështirësi në përgatitjen e ambientit të përshtatshëm për punë më efektive. Kusht i domosdoshëm për funksionimin e ZK-së ka qenë sigurimi i lidhjes me internet, i lidhjes telefonike, i lidhjes së gjeneratorit në rast të mungesës së energjisë elektrike, i pajisjeve për ngrohjen e lokaleve, i angazhimit të kompanisë për sigurim dhe pastrim dhe punë të tjera administrative.

Një ndihmë e rëndësishme për punën e ZK ka qenë pranimi, në pjesën e parë të vitit 2008, i tre zyrtarëve, i Zyrtarit të Lartë për Ffinanca, i Zyrtarit të Prokurimit dhe i Zyrtarit për Teknologji Informativ, të cilët e kanë rritur cilësinë e kryerjes së aktiviteteve të ndryshme, ndonëse në masë jo të dëshirueshme, për shkak të moskompletimit të stafit. Për mungesë të stafit, sidomos të Zyrtarit Certifikues dhe të Zyrtarit Zotues, kemi qenë të detyruar ta trajnojmë stafin ekzistues për kryerjen e këtyre punëve.

ZK ka angazhuar gjithë potencialin e vet në mbrojtjen e interesit të ligjshëm të kërkuesve, duke i realizuar programet e parapara për ofrimin e ndihmës juridike falas dhe duke i koordinuar të gjitha aktivitetet e stafit të Ndihmës juridike. ZK ka marrë pjesë në takime të ndryshme, tryeza të rumbullakëta dhe konferenca dhe në takime me gazetarët e medieeve, të shkruara dhe elektronike, me qëllim të sensibilizimit, jo vetëm të institucioneve të Republikës së Kosovës, por edhe të organeve të tjera shtetërore, qeveritare dhe joqeveritare dhe opinionit të gjerë.

Prej aktiviteteve të shumta veçojmë :

1. Mbajtjen e takimeve me Zyrën Ndërlidhëse të Komisionin Europian, që është angazhuar për realizimin Programit **Mbësëhtetja e drejtësisë**, të paraparë me Projektin “**Human Dynamics**” dhe e cila e mbështetë Ndihmën juridike në formimin e bazës së të dhënave, disenjimin e Web-faqës dhe trajnimin e zyrtarëve ligjorë. Ndihma Juridike është anëtare e Këshillit Drejtues të këtij Projekti

2. Duke qenë e njoftuar se UNDP-a në Republikën e Kosovës e mbështet Programin “**Qasje në drejtësi**”, Zyra Koordinuese e ka njoftuar atë për misionin, objektivat, të arriturat dhe pengesat në aktivitetet e ofrimit të Ndihmës juridike për qytetarët e Republikës së Kosovës. Fal angazhimit dhe mirëkuptimit që ka hasur Zyra, UNDP-ia e ka përfshirë Ndihmën juridike në programin e vet “**Qasje në drejtësi**” dhe, në bazë të një pilot projekti të miratuar nga UNDP- ia do të hapen 5 zyre të reja, duke i punësuar 15 punëtorë, gjë që ka rëndësi të veçantë, jo vetëm për Ndihmën juridike, por ndikon edhe në zvogëlimin, sado të pakët, të shkallës së papunësisë .

3. Takimi me Departamentin për Azil, Kufij dhe Migracion të Ministrisë së Punëve të Brendshme ka qenë frytëdhënës. Në bazë të shënimeve statistikore për migracion dhe azil, ZK ka përgatitur një prezantim me temë “E drejta e azilit në Republikën e Kosovës”, i cili është prezantuar në Konferencën për çështje të azilit, që është mbajtur në Mal të Zi, në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesit e disa vende të rajonit, si: Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia. Përfaqësuesit të ZK i është dhënë hapësirë e veçantë ngase në Konferencë ka paraqitur edhe me temën tjetër me titull “Sistemi i funksionimit të Ndhmës Juridike në Republikën. e Kosovës”.

4. Në dhjetor të vitit 2008 ZK ka pasur takim me të gjithë subjektet përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë. Në takim është vendosur që 16 janari të shpallet **Dita e Drejtësisë**. Përfaqësuesit e Ndhmës juridike janë angazhuar dhe kanë kontribuar në mbarëvajtjen e aktiviteteve të zhvilluara për këtë ditë. Është vendosur që me rastin e shpalljes së Ditës së Drejtësisë, zyrtarët nga 5 BQNJ-të t’ u ofrojnë ndihmë juridike të drejtpërdrejtë qytetarëve të interesuar për zgjidhjen e kontesteve. Gjithashtu është vendosur, që në sesionin tjetër, Koordinatorja e Ndhmës juridike, së bashku me Ombudspersonin, kryetarin e Odës së Avokatëve të Kosovës, Kryetarin e Shoqatës së Gjyqtarëve dhe dekanen e Fakultetit Juridik, të zhvillojnë debat me qytetarët.

### **Trajnimet**

Me qëllim të avancimit profesional të stafit të Ndhmës juridike, në vitin 2008 janë mbajtur 26 trajnime me tema të ndryshme, nga fusha juridike, të drejtat e njeriut, financat, prokurimi etj. Trajnimi i personelit të Ndhmës juridike ka ndikuar në ngritjen e cilësisë së shërbimeve profesionale.

### **Edukimi dhe ngritja e vetëdijës së publikut**

Në periudhën e 2008 ZK ka organizuar dhe realizuar përrurimin e 5 byrove të qarkut për Ndhmë juridike. Në përrurim kanë marrë pjesë përfaqësuesit e institucioneve qeveritare, të gjykatave të qarkut, të gjykatave komunale, të qendrave për punë sociale, të policisë, etj.

USAID-i ka financuar botimin e broshurave në gjuhën shqipe, serbe, turke, rome dhe angleze, për rolin dhe funksionimin e Ndhmës juridike, me qëllim që t’i informojë shfrytëzuesit potencialë mbi të drejtat e tyre nga lëmi civile, administrative, marrëdhënia e punës, etj.

Me qëllim të ngritjes së vetëdijes dhe edukimit juridik, ZK ka realizuar spotin televiziv, duke i paraqitur tri situata: një nga kontesti pronësor juridik, një nga kontesti familjar dhe një nga kontesti i marrëdhënies së punës. Spoti është emituar në RTK, në terminin para lajmeve kryesore, 9 ditë me radhë, para Vitit të Ri, kur shikueshmëria e programit është më e lartë, në tre programe : në gjuhën shqipe, serbe dhe boshnjake. Qëllimi i emetimit të spotit ka qenë vetëdijësimi i qytetarëve për ekzistimin dhe rolin e KNJ-së në mbrojtjen e të drejtave të tyre.

## **Prezantimet**

Gjatë vitit 2008 Ndihma juridike e Kosovës është prezantuar edhe jashtë kufijve të Republikës së Kosovës. Kjo tregon se vendet në regjion kanë njohuri se ekziston institucioni i Ndhmës Juridike.

1. Miloçer-Mali i Zi, me temë “Ndhma Juridike e Republikës së Kosovës “, që ka pasur për qëllim, përveç tjerash, edhe njoftimin e pjesëmarrësve dhe të opinionont për ndihmën juridike që ofron Kosova edhe për personat e zhvendosur nga Kosova në Serbi. Pjesëmarrëja në Tryezën e rrumbullakët është realizuar sipas ftesës së Catholic Relief Servisis, nga Beogradi. Pjesëmarrësit nga regjionet e republikave të ish- Jugosllavisë, e kanë shpallur më të mirin prezantimin e përfaqësuesve tanë.

2 Koordinatorja edhe 3 zyrtarë ligjor nga BQNJ e Prizrenit dhe e Gjilanit, kanë marrë pjesë në Konferencën e organizuar nga IRZ-Fondacioni Gjerman, e cila është mbajtur në Petrovac na Moru të Malit të Zi. Koordinatorja ka prezantuar temën, “Sistemi i Ndhmës Juridike në Republikën e Kosovës” kurse Zyrtarja Ligjor ka prezantuar temën “E drejta në azil, sipas Ligjit për azil në Republikën e Kosovës”.

3. Sipas ftesës së Këshilltares për drejtësi të EULEX-it, znj. Elina Nurmela, Koordinatorja ka realizuar një prezantim për gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë, me temë “Sistemi gjithëpërfshirës i Ndhmës juridike në Republikën e Kosovës”. Prezantimi është mbajtur në ndërtesën e EULEX-it, më 28.11.2008.

4. Koordinatorja për Ndhmë juridike, ka qenë e ftuar nga IRZ-Fondacioni Gjerman, për ta prezantuar Ndhmën Juridike të Kosovës edhe në një konferencë që është mbajtur në Dubrovnik por, fatkeqësisht, për shkaqe teknike, nuk ka mundur të udhëtojë.

## **Paraqitja në media**

Gjatë vitit 2008, stafi i NJ ka qenë në disa nga mediat , me qëllim që ta njoftojë opinionin e gjerë për mundësitë që ofron NJ, si në:

1. Radio Blu Skay, emisini në gjuhën shqipe
2. TV Dukagjini, Pejë, emisioni në gjuhën shqipe

3. RTK- emisioni në gjuhën serbe
4. Gazetën “Kosova Sot”
5. Gazetën “ Fokus”, botimi në gjuha shqipe, serbe dhe angleze
6. Komisioneri në RTK, emisioni në gjuhën serbe.

## Financat

Në kuadër të Zyrës Koordinuese punon edhe Zyrtarja e Lartë për Financa e cila, që nga fillimi i punës, në korrik të 2008, është ballafaquar me problemet e procedimit të faturave të papaguara, të trashëguara nga UNMIK-u.

Buxheti i KNJ-së për vitin 2008 është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, në shumën prej 275 672.00€

Nga shuma e tërësishme, KNJ-a, gjatë vitit 2008, ka realizuar 66.25% të mjeteve nga buxheti i caktuar.

| Vijat buxhetore              | Buxheti i miratuar | Mjetet e dhëna     | Mjetet e shpenzuara | Mjetet e mbetura  |
|------------------------------|--------------------|--------------------|---------------------|-------------------|
| <b>Pagat</b>                 | 59. 560,00         | 59. 560.00         | 53.234,53           | 6.325,47          |
| <b>Komunalit</b>             | 6.260,00           | 6. 260.00          | 4.425,66            | 1. 834.34         |
| <b>Mallrat dhe shërbimet</b> | 209. 852,00        | 194. 352,00        | 114.724.12          | 79. 627,88        |
| <b>Gjithsej</b>              | <b>275. 672,00</b> | <b>260. 172,00</b> | <b>172. 384,31</b>  | <b>87. 787,69</b> |

### Paraqitja e shpenzimeve për vitin 2008


Gjatë periudhës janar-korrik, buxheti dhe financat janë menaxhuar nga UNMIK- u. Gjatë këtij mandati janë shpenzuar 11% të buxhetit, duke u përfshirë edhe pagat e mëditjet. Për këtë arsye, pas rishikimit të buxhetit, nga vija buxhetore kemi pasur prerje të buxhetit në vlerë prej 15 500 € në mallra dhe shërbime.

Në gjysmën e dytë të vitit 2008, buxheti i KNJ pëson ndryshime, prej 275 672.00 € në 260 172.00 € Për këtë arsye edhe përlllogaritja e shpenzimeve është bërë nga mjetet e dhëna.

Pasi që KNJ-a ka filluar me menaxhimin e buxhetit dhe financave nga gjysma e dytë e korrikut të vitit 2008, e kemi parë të arsyeshme që shpenzimet e buxhetit të KNJ-së për vitin 2008, të paraqiten në periudha të ndryshme

| Vijat buxhetore       | Janar - Mars | Prill-Qershor | Korrik-Shtator | Tetor-Dhjetor | Gjithsej   |
|-----------------------|--------------|---------------|----------------|---------------|------------|
| Pagat                 | 7. 871,8     | 17. 078,25    | 14. 629,65     | 13. 655,5     | 53. 234,53 |
| Mallrat dhe shërbimet | 2. 342,26    | 8.124,35      | 14. 851,71     | 89. 405,80    | 11.4724,12 |
| Shpen. Komunale       | 0            | 0             | 1. 603,86      | 2. 821,80     | 4. 425,66  |
| Gjithsej              | 10. 214,14   | 25. 202,60    | 31. 085,22     | 105.882,35    | 172.384,31 |

## 2. Paraqitja e shpenzimeve sipas periudhave kuartale ( tremujore)





| <b>Muajt</b>    | <b>Pagat</b>      | <b>Mallrat dhe shërbimet</b> | <b>Sh. komunale</b> | <b>Gjithësej</b>  |
|-----------------|-------------------|------------------------------|---------------------|-------------------|
| <b>Janar</b>    | 0                 | 0                            | 0                   | 0                 |
| <b>Shkurt</b>   | 4 204.20          | 0                            | 0                   | 4 204.20          |
| <b>Mars</b>     | 3 667.18          | 2 342.26                     | 0                   | 6 009.44          |
| <b>Prill</b>    | 8 447.25          | 1 464.00                     | 0                   | 9 911.25          |
| <b>Maj</b>      | 4 204.20          | 3 282.35                     | 0                   | 7 486.55          |
| <b>Qershor</b>  | 4 426.80          | 3 378.00                     | 0                   | 7 804.80          |
| <b>Korrik</b>   | 4 744.95          | 450.00                       | 0                   | 5 194.95          |
| <b>Gusht</b>    | 5 013.75          | 2 982.40                     | 141.35              | 8 137.50          |
| <b>Shtator</b>  | 4 870.95          | 11 419.31                    | 1 462.51            | 17 752.77         |
| <b>Tetor</b>    | 4 870.95          | 16 624.40                    | 1 542.54            | 23 037.89         |
| <b>Nëntor</b>   |                   | 5 704.32                     | 672.94              | 6 377.26          |
| <b>Dhjetor</b>  | 8 784.30          | 67 077.08                    | 606.32              | 76 467.70         |
| <b>Gjithsej</b> | <b>53. 234,53</b> | <b>114 724,12</b>            | <b>4.425.66</b>     | <b>172.384.31</b> |

### 3. Paraqitja e shpenzimeve sipas muajve të vitit-2008

#### Prokurimi

Për lëndët e prokuruar janë zhvilluar procedurat e rregullta të prokurimit në pajtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik në Kosovë. Gjithmonë është zbatuar procedura standarde për marrjen e ofertave nga ofertuesit, formimin e komisioneve për hapjen dhe vlerësimin e tyre dhe lidhjen e kontratave me operatorët ekonomikë që janë përzgjedhur.

Në periudhën janar-korrik 2008, buxheti i Komisionit për Ndihmë Juridike është menaxhuar nga UNMIK-u, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë. Procedurat e prokurimit për nevojat e Komisionin për Ndihmë Juridike i ka zhvilluar Departamenti i Administratës Qendrore i Ministrisë së Drejtësisë dhe për këtë periudhë nuk kemi shënime për lëndët që janë prokuruar. DAQ-i i MD-së nuk ka bërë evidentimin e procedurave të prokurimit në mënyrë të ndarë për Komisionin e Ndihmës Juridike.

Në periudhën korrik- dhjetor 2008, kur KNJ-a ka filluar vetë të menaxhojë procedurat e prokurimit, Zyra e Prokurimit në kuadër të Zyrës Koordinuese për Ndihmë Juridike, ka zhvilluar këto aktivitete të prokurimit : ka shpallur një tender të hapur për furnizim me vlerë të mesme, katërmbëdhjetë tenderë me procedurë të zgjedhjes së çmimit më të leverdishëm, për furnizim dhe shërbime me vlerë të vogël dhe dy procedura me vlerë minimale, njëra për shërbime ndërsa tjetra për furnizim. Procedurat e zhvilluara në këtë zyre janë pasqyruar në tabelën e më poshtë :

| <b>PËRSHKRIMI</b>                             | <b>SHUMA</b>       |
|---|--------------------|
| Tenderi për furnizim, procedura e hapur       | 6.400,00 €         |
| Procedurë për kuotimin e çmimeve (furnizim)   | 45.317,00 €        |
| Procedurë për kuotimin e çmimeve (shërbimeve) | 10.022,50 €        |
| Procedura për vlerë minimale                  | 0,00 €             |
| <b>TOTALI</b>                                 | <b>61.739,50 €</b> |

## **7. AKTIVITETE E BYROVE TË QARKUT PËR NDIHMË JURIDIKE (BQNJ)**

Aktualisht ofrimi i ndihmës juridike shtrihet në tërë territorin e Republikës së Kosovës nëpërmjet byrove të qarkut për Ndihme juridike në 5 regjione të Republikës së Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan. Në BQNJ-të, në mënyrë të drejtpërdrejtë, çdo qytetari në gjendje të vështirë materiale, që i plotëson kriteret e përcaktuara në RRNJ, i ofrohet ndihmë juridike në lëmin civile, administrative dhe penale.

Të gjitha byrotë e qarkut janë të vendosura në objekte private, me qira. Përveç BQNJ-së në Prishtinë dhe Zyrës Koordinuese në Prishtinë, asnjë BQNJ tjetër s' ka veturë, gjë që e pengon formimin e klinikave juridike në komuna tjera në të cilat qytetarëve do t'u ofrohej ndihmë juridike falas ditëve të caktuara në javë. Kjo ishte arsyeja që Komisioneri i është drejtuar Kryeministrit me kërkesë që të shqyrtohet mundësia e sigurimit të automjeteve për katër BQNJ-të tjera.

Veprimtaria e byrove të qarkut për Ndihmë juridike :

1. Pranojnë kërkesat për ndihmë juridike
2. Vendosin nëse kërkuesi ka të drejtë të bëhet përfitues i ndihmës juridike;

3. Vendosin nëse kërkuesi ka të drejtë në ndihmë juridike primare apo sekondare, gjë që varet nga gjendja e tij financiare;
4. Duke u nisur nga kërkesa e parashtruesit, sigurojnë ofrimin e ndihmës juridike në përputhje me vendimin dhe, varësisht nga rasti, e drejtojnë kërkuesin tek ofruesi i jashtëm të ndihmës juridike, te:
  - avokatët e kërkuar nga kërkuesi apo të caktuar nga lista e shërbimit nëpër qarqe;
  - avokatët e kontraktuar;
  - klinikat e ndihmës juridike;
  - një OJQ në partneritet;
  - programet studentore

Në çdo BQNJ, 2 zyrtarë për ndihmë juridike dhe një asistent administrativ, ofrojnë ndihmën juridike, në lëmin e çështjeve civile, administrative dhe penale.

BQNJ- sigurojnë avokatë kujdestarë për ndihmë juridike emergjente, nëpërmjet telefonit pa pagesë, për të gjithë personat e arrestuar dhe personat e paraburgosur nga policia.

Në vijim është dhënë pasqyra tabelare e regjioneve të përfshira nga BQNJ-të

| Regjionet                  | Komunat                |
|----------------------------|------------------------|
| <b>I. BQNJ, Prishtinë</b>  | 1. Prishtinë           |
|                            | 2. Ferizaj             |
|                            | 3. Podujevë ( Besianë) |
|                            | 4. Lipjan              |
|                            | 5. Drenas              |
|                            | 6. Kaçanik             |
|                            | 7. F.ushshë- Kosovë    |
|                            | 8. Shtime              |
|                            | 9. Kastriot (Obiliq)   |
|                            | 10. Shtërpce           |
|                            | 11. Graçanicë          |
| <b>II. BQNJ, Prizren</b>   | 1. Prizren             |
|                            | 2. Therandë (Suharekë) |
|                            | 3. Rahovec             |
|                            | 4. Malishevë           |
|                            | 5. Dragash             |
|                            | 6. Mamushë             |
| <b>III. BQNJ, Pejë</b>     | 1. Pejë                |
|                            | 2. Gjakovë             |
|                            | 3. Klinë               |
|                            | 4. Deçan               |
|                            | 5. Istog               |
| <b>IV. BQNJ, Mitrovicë</b> | 1. Mitrovicë           |
|                            | 2. Vushtrri            |
|                            | 3. Skënderaj           |
|                            | 4. Leposaviq           |
|                            | 5. Zveçan              |
|                            | 6. Zubin Potok         |
| <b>V. BQNJ, Gjilan</b>     | 1. Gjilan              |
|                            | 2. Dardanë (Kamenicë)  |
|                            | 3. Vitijë              |
|                            | 4. Artanë (Novobërd)   |

Duke ditur se ndihma juridike falas për qytetarët në gjendje të vështirë ekonomike duhet të ofrohet me një qasje gjithëpërfshirëse, multidisiplinore dhe të bazuar në të drejtat e njeriut, gjatë zbatimit të RRNJ 2006/36, zyrtarët e byrove të qarkut gjatë ofrimit të ndihmës juridike për palët përkatëse, kanë pasur parasysh parimet në vijim:

- **Parimi e të drejtave themelore të njeriut dhe mundësi të barabarta-** Qytetarët në gjendje të vështirë ekonomike janë kryesisht “viktima” të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe gëzojnë qasje të barabartë në drejtësi dhe gjykim të drejtë, si parim i të drejtave themelore të njeriut.
- **Parimi i mosdiskriminimit-** Të gjithë kërkuesit e ndihmës juridike falas, janë trajtuar me dinjitet, pa diskriminim, përfshirë këtu *inter alia*, pavarësisht nga përkatësia e tyre racore, mosha, gjinia, feja apo besimi, origjina etnike, kombëtare apo sociale, statusi i lindjes apo tjetër, apo ndonjë kriter tjetër të ngjashëm.
- **Parimi i privatësisë dhe konfidencialitetit.** Privatësia dhe identiteti i kërkuesit të ndihmës juridike falas, duhet dhe është mbrojtur nga të gjithë zbatuesit e procedurës.
- **Parimi i të drejtës për informim** - Të gjithë kërkuesve të ndihmës juridike falas, u është dhënë informata me kohë dhe gjithëpërfshirëse për drejtësinë dhe informata të tjera ligjore.
- **Parimi i ndihmës për persona me nevoja të veçanta-** Kërkuesve të ndihmës juridike falas, të cilit kanë nevoja speciale, u është ofruar ndihmë juridike e duhur dhe e nevojshme.

Përgjegjësit e BQNJ-ve, rregullisht kanë marrë pjesë në takimet mujore, të cilat janë mbajtur në Zyrën Koordinuese. Gjatë takimeve janë shqyrtuar të gjitha çështjet relevante që kanë të bëjnë me ofrimin e ndihmës juridike, problemet dhe pengesat në realizimin e detyrave të besuara dhe mundësitë për tejkalimin e pengesave të paraqitura.

Byrotë e qarkut çdo muaj kanë paraqitur raporte mujore, duke e paraqitur gjendjen faktike dhe statistikën lidhur me numrin e lëndëve, në të gjithë lëmenjtë, që pasqyrojnë strukturën gjinore, kombëtare, veprimet juridike, etj.

Në tabelën në vijim është dhënë numri i palëve të cilëve u është ofruar ndihmë juridike, sipas lëmenjve përkatëse, sipas përkatësisë gjinore dhe kombëtare.

| Byrotë e qarkut sipas regjioneve | Lëmi       |            |           | Gjinia     |            | Përkatësia   |           |           |           |           |           | Nr. i lëndëve |
|----------------------------------|------------|------------|-----------|------------|------------|--------------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|---------------|
|                                  | Civ.       | Adm.       | Pen.      | F          | M          | Sh           | S         | B         | T         | R         | Etj       |               |
| BQNJ-1, Prishtinë                | 142        | 66         | 44        | 97         | 155        | 232          | 6         | 2         | 7         | 2         | 3         | 252           |
| BQNJ-2, Prizren                  | 135        | 128        | 22        | 111        | 174        | 215          | 2         | 14        | 20        | 33        | 1         | 285           |
| BQNJ-3, Pejë                     | 67         | 120        | 10        | 72         | 125        | 170          | 0         | 15        | 0         | 4         | 8         | 197           |
| BQNJ- 4, Mitrovicë               | 43         | 280        | 5         | 79         | 249        | 320          | 0         | 4         | 0         | 3         | 1         | 328           |
| BQNJ- 5, Gjilan                  | 67         | 239        | 16        | 128        | 194        | 312          | 3         | 3         | 0         | 4         | 0         | 322           |
|                                  |            |            |           |            |            |              |           |           |           |           |           |               |
| <b>Gjithsej</b>                  | <b>454</b> | <b>833</b> | <b>97</b> | <b>487</b> | <b>897</b> | <b>1.249</b> | <b>11</b> | <b>38</b> | <b>27</b> | <b>46</b> | <b>13</b> | <b>1.384</b>  |

Pasqyra e lëndëve të ndihmës juridik për vitin 2008 në lëmin civile, adminis. dhe penale

#### Shkurtesat:


1. Civ. = civile
2. Adm.= administrative
3. Pen. =penale
4. F = femra
5. M = meshkuj
6. Sh = shqiptarë
7. S = serbë
8. B = boshnjakë
9. T = turq
10. R = romë
11. Etj. (Ashkalinj, Egjiptianë, Rumunë, Moldavë)

Tabela pasqyron numrin e lëndëve sipas kërkesave. Për shumicën e lëndëve janë ndërmarrë deri në 5 (pesë) veprime juridike.


## Lëmi civile

Në vitin 2008, në lëmin civile, ndihmë juridike falas u është ofruar 454 kërkesve. Prej tyre, 403 lëndë, ose 89 %, në procedurën kontestimore, kurse 49 lëndë, ose 11%, në procedurën jashtëkontestimore.


*Pasqyrë e rasteve të proceduarës civile ↓*



Grafikoni poshtë pasqyron numrin e lëndëve në lëmin civile sipas fushave të ndryshme. Gjatë vitit 2008, 186 kërkesve u është ofruar ndihma juridike për çështje familjare, prej tyre 31 padi për shkurorëzim, 36 raste të dhunës në familje, 25 padi për vërtetimin e pronësisë etj; 200 raste pronësore juridike, prej tyre 69 për vërtetimin e pronësisë, 42 për pengimin e posedimit; 18 të trashëgimisë; 17 për mardhënie pune (kur të punësuarit, pa fajin e tij, i është ndërprerë marrëdhënia e punës) dhe 33 lëndë janë të rasteve tjera, si: ndarja fizike, shpallja e personit të zhdukur si të vdekur, etj.




Sa i përket veprimeve juridike në lëmin civile, grafikoni në vijim tregon se në 1111 raste, ose 74%, të veprimeve juridike, janë përpiluar shkresa të ndryshme: padi, ankesa kërkesa, kundërshtime, etj; në 194 raste, ose 13 %, ndihma juridike është ofruar me këshilla juridike dhe në 201 raste, ose 13 %, lëndë janë referuar te avokati.



## Lëmi administrative

Nga grafikoni që vijon, është dhënë gjendja faktike e kërkuësve të ndihmës juridike falas, nga shihet se në 632 raste, ose 82 %, kërkuësve u është ofruar ndihmë juridike për çështje sociale (fitimi i të drejtës për shfrytëzimin e ndihmës sociale, lidhjen e kontratave për shkëputje nga bashkësia familjare, etj); kurse në 137 raste, ose 18 %, në çështje pensionale (pensioni i pleqërisë, pensioni invalidor, pensioni për personat me aftësi të kufizuara, etj)






## Lëmi penale

Për shkak të mosgatishmërisë së Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KNJ-a nuk ka arritur marrëveshje mirëkuptimi për bartjen e buxhetit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në KNJ për ofrimin e ndihmës juridike në çështjet penale, përkatësisht për rastet e caktimit të avokatëve ex officio, gjë që ka penguar angazhimin e avokatëve për këto çështje.

Për këtë arsye BQNJ-të kanë ofruar ndihmë juridike në çështje penale, vetëm duke dhënë këshilla juridike dhe duke ndihmuar në përpilimin e shkresave.

Në lëmin penale, në 71 raste, ose 87 % është ofruar ndihma juridike për vepra penale (kallëzim penal, këshilla juridike, ankesa, etj.), kurse në 11 raste, ose 13 %, është ofruar ndihma juridike lidhur me procedurën e shkurtër (kundërshtimi kundër urdhërit ndëshkimor, vërejtjes gjyqësore, etj) .



## **8. BASHKËPUNIMI I KOMISIONIT PËR NDIHMË JURIDIKE ME ODËN E AVOKATËVE (OAK)**

Siç është paraparë me nenin 7.1. të RRNJ-2006/37, Komisioni bashkëpunon me OAK në përcaktimin e masave pozitive për të siguruar përfaqësim të drejtë të përfituesve të ndihmës juridike. Me një solemnitet rasti, në praninë e përfaqësuesve të Qeverisë, organeve shtetërore dhe organizatave ndërkombëtare, KNJ ka lidhur Marrëveshje mirëkuptimit për bashkëpunim me Odën e

Avokatëve të Kosovës, me qëllim të angazhimit të avokatëve, në raste kur përfituesit e ndihmës juridike duhet të përfaqësohen në procese gjyqësore.

Marrëveshja e mirëkuptimit përcakton obligimin e OAK-së, që çdo 3 (tre) muaj, për KNJ-në, të azhurnojë listat e avokatëve të gatshëm që të përfaqësojnë përfituesit e ndihmës juridike.

### ***9. BASHKËPUNIMI I KOMISIONIT PËR NDIHMË JURIDIKE ME OJQ-të NË PARTNERITET***

Me nenin 8 pika(d) e RRNJ, nr 2006/36, është paraparë që Komisioni i Ndhmës Juridike mund të hyjë në partneritet me OJQ-të, me qëllim që t'u ofrojnë ndihmë juridike grupeve të cenuara brenda zonave të përkufizuara gjeografike, apo atyre me kompetenca të veçanta.

Megjithatë, për shkaqe objektive, Komisioni nuk ka arritur të hyjë në partneritet me OJQ-të siç është paraparë me RRNJ.

### ***10. BURIMET FINANCIARE DHE NIVELI I FINANCIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE***

Meqenëse Komisioni për Ndhmë Juridike është institucion i pavarur, shtetëror, çështja e financimit është rregulluar me RRNJ, nr. 2006/36. Neni 4.14. i kësaj Rregulloreje përcakton se mjetet financiare për buxhetin e KNJ-së sigurohen çdo vit nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe planin e buxhetit të paraqitur nga KNJ, e miraton Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Në pajtim me pikën 4.15 (k) të RRNJ, kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit përfshijnë planifikimin e buxhetit për ndihmë juridike dhe sigurimin e mjeteve financiare nga donatorët, Qeveria dhe autoritetet tjera buxhetore .

### ***11. PROBLEMET MANGËSITË DHE PENGESAT NË SISTEMIN E NDIHMËS JURIDIKE***

Fondet për funksionimin e KNJ-së sigurohen nga Buxheti i Kosovës. Mirëpo, deri më tani, në periudhën kohore prej dy vitesh e gjysmë, e sidomos nga momenti kur KNJ-a është pavarësuar nga DD i UNMIK-ut, ka hasur në vështirësi të ndryshme. Për mungesë të përkrahjes institucionale, KNJ

nuk i janë dhënë sasi e nevojshme e mjeteve finaciare, që janë të domosdoshme për funksionimin e rregullt të KNJ-së dhe për ruajtjen e pavarësisë së këtij institucioni me rëndësi të veçantë.

**Numri i vogël dhe i pamjaftueshëm i personelit** - Numri i vogël i zyrtarëve dhe pamundësia e kompletimit të stafit është pasojë e buxhetit të limituar, gjë që ka qenë dhe paraqet problem thelbësor në përmbushjen e plotë të misionit të këtij institucioni. Mungesa e zyrtarëve ka ndikuar edhe në afatin e kryerjes së punëve .

**Pagat** - Niveli i pagave të stafit në KNJ është jostimulues dhe aspak motivues për ekspertë të kësaj fushe. Stafit i këtij institucioni të rëndësishëm duhet të stimulohet dhe, patjetër, duhet bërë kategorizimi i pozitave me rëndësi të veçanta.

**Rreziku nga largimi eventual i personelit ekzistues** – Për shkak të të ardhurave të pakta personale në KNJ, jo vetëm që s’ ka gjasa të kompletohet stafi i nevojshëm, por ka rrezik të largohen edhe zyrtarët e tanishëm, për ngritjen profesionale të të cilëve KNJ-a ka mobilizuar të gjitha mundësitë që i ka pasur. Largimi eventual i zyrtarëve që janë të inkuadruar drejtpërdrejt në të gjitha proceset e punës së ndihmës juridike, do e rrezikonte funksionimin e KNJ-së në tërësi.

**Buxheti** - Në dy vitet që lamë pas, Kuvendi i Republokës së Kosovës nuk e ka miratuar kërkesën e KNJ për mjete buxhetore për paga dhe meditje. Mungesa e mjeteve buxhetore ka bërë që KNJ-a të ballafaqohet me pengesa dhe vështirësi në funksionimin e suksesshëm të tij.

**Mungesa e mjeteve materiale** – RRNJ 2006/36 parasheh krijimin e klinikave juridike nëpër komuna tjera të Republikës së Kosovës. Duke u nisur nga fakti se një regjion mbulon më shumë komuna, përfituesit e ndihmës juridike falas kanë vështirësi, si subjektive ashtu edhe objektive për realizimin e të drejtave të tyre, për arsye se byrotë e qarkut janë në një distancë gjeografike të madhe, prandaj formimi i këtyre klinikave është i domosdoshëm. Në mungesë të mjeteve materiale për blerjen e veturave, KNJ-a nuk ka arritur që nëpërmjet klinikave juridike, qytetarëve të komunave të ndryshme, t’u ofroj shërbimet e ndihmës juridike.

**Byrotë e qarkut për ndihmë juridike** – Janë të vendosura në objekte private dhe nuk garantojnë shfrytëzim për periudha të gjatë kohore. Pronarët e tyre shpesh kërkojnë t’ ua lirojnë ato për arsye nga më të ndryshmet. KNJ-a i është drejtuar Kryeministrit me kërkesë që institucioni për NJ të vendoset në ndonjë objekt qeveritar, por deri me tani s’është marrë ndonjë vendim.

## ***12. REKOMANDIMET***

- a. Është e domosdoshme të nxirret Ligji për ndihmë juridike falas. Pervoja e deritashme ka treguar se Rregullorja aktuale për ndihmë juridike, nr.2006/36, nuk i përfshinë të gjitha çështjet me rëndësi për ndihmë juridike. Përveç kësaj, kjo Rregullore është e tejkaluar për vetë faktin se ajo nuk është e harmonizuar me legjislacionin e Republikës së Kosovës.
- b. Është i nevojshëm sensibilizimi i vazhdueshëm i institucioneve dhe organeve të Republikës së Kosovës për rëndësinë që duhet kushtuar këtij institucioni dhe edukimi e ngritja e vetëdijes së qytetarëve për rolin dhe mundësitë që u ofron KNJ.
- c. Është e domosdoshme ngritja e mëtejme profesionale e stafit të këtij institucioni për shfrytëzimin e të gjithë mekanizmave ekzistues ligjor për ndihmë juridike.